


PERMBLEDHJE JO TEKNIKE

Aktiviteti: Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtaritë e lidhura me to ID 7.7 f. Trajtim ose magazinim i peshqve të ngordhur ose mbetjeve të peshqve.

Subjekti "SALI FISH" sh.p.k

Anila Sali

Administrator



Qershor 2025

TABELA PERMBLEDHESE

| | |
|--------------------------------------------------------------------|----|
| Hyrje | 3 |
| 1. VENDNDODHJA E OBJEKTIT | 4 |
| 2. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT, PROCESET DHE LINJA TEKNOLOGJIKE | 9 |
| 3. VLERSIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS | 13 |
| 4. REKOMANDIME PER ZBUTJEN E NDIKIMEVE | 16 |

Hyrje

Ky raport, hartohet per aktivitetin **“Trajtim ose magazinim i peshqve të ngordhur ose mbetjeve të peshqve”** me qellim pajisjen me leje mjedisore tipi B, sipas VENDIM Nr. 419, datë 25.6.2014 PËR MIRATIMIN E KËRKESAVE TË POSAÇME PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR LEJE MJEDISI TË TIPAVE A DHE B, PËR TRANSFERIMIN E LEJEVE NGA NJË SUBJEKT TE TJETRI, TË KUSHTEVE PËR LEJET RESPEKTIVE TË MJEDISIT, SI DHE RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR SHQYRTIMIN E TYRE NGA AUTORITETET KOMPETENTE DERI NË LËSHIMIN E KËTYRE LEJEVE NGA QKB-JA12 (Ndryshuar me VKM nr. 97, datë 14.2.2018; nr. 463, datë 26.7.2023), kreu VI INFORMIMI DHE PJESËMARRJA E PUBLIKUT PËR APLIKIMIN PËR LEJE MJEDISI TË TIPIT A DHE B

Subjekti **“SALI FISH”** sh.p.k kerkon te pajiset me leje mjedisore tipi B sipas Shtojces 1, te Ligjit Nr. 52/2020 për disa ndryshime në ligjin Nr. 10 448, datë 14.7.2011, **“Për lejet e mjedisit”**, të ndryshuar.

“Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtaritë e lidhura me to”

ID 7.7 f. Trajtim ose magazinim i peshqve të ngordhur ose mbetjeve të peshqve.

Qellimi i ketij raporti per veprimtarine eshte:

- Te jape informacion per vendim-marresit per pasojat mjedisore te veprimeve te propozuara;
- Te promovoje zhvillimin miqesor dhe te qendrueshem me mjedisin duke identifikuar masat e duhura per permiresimin dhe zvogelimin e ndikimeve ne mjedis.

Objektivat e ketij relacioni ndahen ne dy kategori:

- **Objektivi i pare** eshte te informoje procesin e vendim-marrjes duke identifikuar ndikimet e konsiderueshme potenciale ne mjedis dhe rreziqet e perfitimet te projektit dhe zhvillimit te propozuar.
- **Objektivi dyte dhe perfundimtar** eshte te promovoje zhvillimin e qendrueshem duke siguruar qe propozimet e projektit nuk ndikojne ne funksionet ekologjike ose mireqenien, stilin e jetes dhe jetesen e komunitet si dhe te njerezeve qe lidhen apo varen nga ky projekt ose veprimtari.

1. VENDNDODHJA E OBJEKTIT


Aktiviteti “**Trajtim ose magazinim i peshqve të ngordhur ose mbetjeve të peshqve** “ do te zhvillohet ne nje siperfaqe prej 994 m² e llojit Are, ne fshatin Mbrostar-Ura, Njesia Administrative Mbrostar, Bashkia Fier.

Prona me nr. Pasurie 82/63, Zk 2636, siperfaqe 994 m², eshte ne pronesi te z. Idajet Veliu.

Mbi kete pasuri pala qiradhenese pronare e pasurise sipas Vendimit nr.413, date 22/11/2019 per miratimin e lejes se ndertimit “Objekt Bujqesor 1-Kat dhe Hangare ne funksion te bujqesise” Lejes se ndertimit date 22/11/2019 dhe Certificate Perdorimi date 19/07/2021 ka nenshkruar kontrate qiraje me shoqerine “Sali Fish” me nr. repertori 909 dhe nr. koleksioni 505, date 28.05.2025 per nje periudhe 5-vjeçare.

Impianti bene pjese ne Njesine Strukturore 7/73 me karakteristikat e meposhte:

| | |
|----------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Bashkia | Fier |
| Njësia | 7/73 |
| Sistemi | UB_Urban |
| Kategori 1 | S.Shërbime 40% |
| Kategori 2 | B. Bujqësi 30% |
| Kategori 3 | IE. Industri dhe Ekonomi 30% |
| Lartësia në Kate | 4 |
| Lartësia në Metra | 14 |
| PDV | JO |
| Intesitet | K1=1.5 K2=Sipas legjislacionit dhe kësaj rregullorje K3=2.5 |
| KSHT | K1=50% K2=Sipas legjislacionit dhe kësaj rregulloreje K3= 50% |
| KSHR | 10% |
| KSHP | 0% |
| Kufizime Ligjore | |
| Sipërfaqe (ha) | 94.15 |
| Parcela_Minimale | Sipas planit dhe kësaj rregulloreje |
| Përdorime të Lejuara | Të gjitha ato që nuk janë të ndaluara |
| Përdorime të Ndaluar | Përdorimet e vecanta, ushtarake dhe të gjitha ato që nuk i shërbejnë kategorisë bazë bujqësi e industri dhe ekonomi. |



Duke ju referuar Planit të Pergjithshëm Vendor të Bashkisë Fier dhe karakteristikave të njësise strukturore ku ndodhet objekti, ky aktivitet përfshihet në kategoritë e lejuara të zhvillimit në këtë zonë.

Koordinatat sipas sistemit Gauss Kruger të parcelës ku ndodhen objektet në të cilat zhvillohen aktivitetet janë:

| NR | X | Y |
|----|-------------|-------------|
| 1 | 4381001.376 | 4515802.085 |
| 2 | 4380985.543 | 4515755.804 |
| 3 | 4381103.659 | 4515742.621 |
| 4 | 4381092.010 | 4515686.020 |

ORTOFOTO



Koordinatat sipas sistemit Gauss Kruger te objekteve jane:

| Objekti 1 | | | Objekti 2 | |
|-----------|-------------|-------------|-------------|-------------|
| NR | X | Y | X | Y |
| 1 | 4381050.012 | 4515738.591 | 4381049.490 | 4515718.683 |
| 2 | 4381061.100 | 4515756.982 | 4381068.833 | 4515706.802 |
| 3 | 4381068.460 | 4515752.394 | 4381088.862 | 4515739.517 |
| 4 | 4381057.414 | 4515734.129 | 4381069.785 | 4515751.691 |

PLAN VENDOSJE

QERAMARRESI: SALI FISH DATE 17/06/2025 QELLIMI (INFORMACION)

VENDVODHJA SBROSTAR URA
 BASHKIA FIER DV'ASHEK / ZV'ASHEK FIER ZONA KADASTRALE 2636 NUMRI PASURISE 72/63 INDEKSI HARTES K-34-112-(176-B)
 TE DHENAT E PASURISE
 LLOJI PASURISE: ARE SIP.PASURISE= M2 SIP.GJURMES NDERTIMIT= M2 NUMRI KATJEVE KT NUMRI I PEMEVE

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPETARE

SHPJEGUES

SISTEMI KOORDINATIV GAUSS KRUGER

| | | | |
|---------------------------------------|---------------------------------------|---------------------------------------|---------------------------------------|
| PA1 X:4381050.012 Y:4515738.591 | PB1 X:4381049.490 Y:4515718.683 | PC1 X:4381061.100 Y:4515756.982 | PD1 X:4381088.862 Y:4515739.517 |
| PA2 X:4381061.100 Y:4515756.982 | PB2 X:4381068.833 Y:4515706.802 | PC2 X:4381068.460 Y:4515752.394 | PD2 X:4381069.785 Y:4515751.691 |
| PA3 X:4381068.460 Y:4515752.394 | PB3 X:4381088.862 Y:4515739.517 | PC3 X:4381057.414 Y:4515734.129 | PD3 X:4381049.490 Y:4515718.683 |
| PA4 X:4381057.414 Y:4515734.129 | PB4 X:4381069.785 Y:4515751.691 | PC4 X:4381050.012 Y:4515738.591 | PD4 X:4381061.100 Y:4515756.982 |

SH 1:1000

| Nr. | Orientimi | Perdorimi | Tipi kufirit | Kufitari | ID / Nipt | Shenime te realizuesit |
|-----|-----------|-----------|--------------|----------|-----------|------------------------|
| 1 | VERI | | | | | |
| 2 | LENDJE | | | | | |
| 3 | JUG | | | | | |
| 4 | PERENDIM | | | | | |

REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT
 EMRI : GEZIM HAZIZI
 LISHENCA : NR.10324/1 DATE 26.06.2017
 KOMPANIA STUDIO TOPOGRAFIKE FIERI
 NPT: K-92521401-0
 NENSHKRIMI/VULA _____

REALIZOI PER ASHEK
 SPECIALIZE DV'ASHEK **Gezim** Dignally signed by Gezim Hazizi Date: 2025.06.17 12:15:57 +02'00'
 HENSHKIMI **Hazizi**
 KONFIRMIMI
 PERGJEGHES/DREKTORI
 NENSHKRIMI/VULA _____

TEKNOLOGJIA E MATJEVE I
 Kode per teknologjine e matjeve : T-Terren ; O-Ortofoto ; G-GPS ; S-Station Total ; D- Matje Distancash

PERCAKTIMI KUFIRIT BK
 Kode per percaktimin e kufirit : P - Perfagesnesi i pronave ; K - Kufitarete te Gjithe ; Kp - Kufitarete Pjeseresh
 PB - Perfagesnes Bashkë ; BK - Harta Kadastrale

SHENIME TE VECANTA: SISTEMI KOORDINATIV GAUSS KRUGER

PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARDHENIET ME KUFITARET

EMRI _____
 NENSHKRIMI _____

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimin e kufirit : T-Terren ; O-Ortofoto ; G-GPS ; S-Station Total ; D- Matje Distancash ; P - Perfagesnesi i pronave ; K - Kufitarete te Gjithe ; Kp - Kufitarete Pjeseresh ; PB - Perfagesnes Bashkë ; BK - Harta Kadastrale

PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE E PROJEKTUAR MBI ORTOFOTO SIPAS GOOGLE EARTH 2024

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPETARE



SH 1:1000

Foto Pamje nga ambjentet ku do te zhvillohet aktiviteti



Objekti ndodhet ne fshatin Mbrostar Ura dhe i perket Njesise Administrative Mbrostar, Bashkia Fier.

Objekti ka akses me rrugen dytesore qe e lidhe me bypassin e Fierit.

2. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT, PROCESET DHE LINJA TEKNOLOGJIKE

Shoqeria "SALI FISH" sh.p.k e regjistruar ne QKB me NIPT L71724501P me administrator z. Anila Sali, ushtron aktivitetin e saj ne Import - Export te peshkut dhe nenprodukteve te tij. Kjo shoqeri do ta ushtroje kete aktivitet, duke zbatuar te gjitha kufizimet dhe hapesirat ligjore qe percakton kuadri ligjor i fushes ne Republiken e Shqiperise. Ne kete kuptim kjo shoqeri do te operoje ne tregun shqiptar, duke pasur ne baze te veprimtarise tregtare te saj, te gjitha porosit apo ofertimet qe mundesojne kryerjen e kesaj veprimtarie tregtare duke shfrytezuar potencialin e saj teknik dhe financiar. Ne kete kontekst shoqeria do te respektoje te gjitha normat dhe kushtet e tregut shqiptar ne kete fushë.

Linja e perpunimit magazinimit te peshkut dhe nenprodukteve te tij do te ne nje objekt Bujqesor 1-Kat dhe Hangare ne funksion te bujqesise me siperfaqe rreth 1080.75 m² ne fshatin Mbrostar Ura.

Objekti i cili eshte i ndertuar me panele sanduich do te pershtatet ne funksion te aktivitetit duke bere punime per ndarjen e ambjenteve te brendshme sipas planimetrise se projektuar.


Ambjentet qe do te krijohen jane:

Ne objektin me siperfaqe 888.75 m² do te ndertohen dy ambjente:

- Salla e punetoreve
- Ambjentet ku jane vendosur makinerite (frigoriferet, makineria larese, etj)

PLANIMETRIA E OBJEKTIT TE SUBJEKTIT "SALI FISH" ME SIPERFAQE 888.75 M2 NDODHUR NE ZK: 2636 FSHATI MBROSTA URA, BASHKIA FIER

SHKALLA 1:150




Ne objektin me sipërfaqe 192 m² do të ndërtohen ambjentet për punëtorët:

- Mënc
- Zyre
- WC
- Garderob dush

PLANIMETRIA E OBJEKTIT TE SUBJEKTIT "SALI FISH" ME SIPERFAQE 192 M2
NDODHUR NE ZK: 2636 FSHATI MBROSTA URA , BASHKIA FIER

SHKALLA 1:150



Qellimi i këtij aktiviteti është përpunimi, ambalazhimi dhe magazinimi i perkoqshëm i peshqve, duke furnizuar me produkte cilësore tregun vendas.

TEKNOLOGJIA

Teknologjia e përdorur për përpunimin e peshkut dhe nënprodukteve të tij është e rëndësishme për të diferencuar produktin e prodhuar nga konkurrentet. Ky biznes vlerëson prodhimin me teknologji të sofistikuar pasi janë me produktive dhe kosto të minimizuara.

Kapaciteti i përpunimit është **15-20 ton/muaj peshk**.

Lenda e parë **peshku (acuge)** e cila vjen në objekt me arka polisteroli të mbuluar me akull në rast kur produkti është i freskët ose në fuci plastike kur produkti është i kriposur. Transporti i tyre bëhet me automjete frigoriferike për të ruajtur në kushte të caktuara duke monitoruar dhe temperaturën gjatë fazës së transportit. Subjekti do të furnizohet nga shoqëri të perzgjedhura "Mare Adriatik" dhe "Acquarion".

Proceset e perpunimit per peshkun (acugen)

✓ Larje e produktit

Lenda e pare peshku (acuge) transferohet në brendësi të mbajtëseve të posacme ku i nënshtrohet procesit te larjes me uje ne rastin kur peshku vjen i fresket ne arka polisteroli..

Ne rastin kur produkti vjen ne aktivitet i kriposur dhe te ruajtura ne fuçi plastike behet pranimi i tij nqse i permbush kushtet higjenike dhe kushtet e ruajtjes ne temp e duhura dhe magazinohet ne frigorifer ne temperature 0-4°C.

- ✓ Procesi i perpunimit fillon me shkrikerimin e acuges nga kripa nepermjet nje ndarje manuale.
- ✓ Peshku i kriposur lahet ne makinerine larese
- ✓ Peshku i lare thahet ne centrifuge per te bere gati per filetim.
- ✓ Acugia e kriposur filetohet dhe vendoset ne qese plastike te cilat me pas peshohen ,ambalazhohen ,etiketohen.
- ✓ Pas paketimit magazinohen ne temperature frigoriferike 4-5°C deri ne momentin e tregtimit te tij.



Foto 1 Makineria e larjes se produktit



Foto 2 Makineria e paketimit



Foto 3 Dhoma frigoriferike

Lendet e para:

- ✓ Peshq
- ✓ Kripe

Peshq: Subjekti do te furnizohet nga shoqeri te perzgjedhura "Mare Adriatik" dhe "Acquarion".

Lende ndihmese:

- ✓ Uje
- ✓ Energji Elektrike

Uji: Per realizimin e procesit te larjes se lendes se pare uji do te sigurohet nga sistemi i furnizimit me uje te pijshem nepermjet kontrates qe subjekti do te lidhe me shoqerine e ujesjelles kanalizime te bashkise Fier.

Energji elektrike: Furnizimi me energji elektrike kryhet nga rrjeti ekzistues i furnizimit me energji elektrike te objektit dhe perdoret per ndricimin e objektit, venien ne pune te makinerive dhe frigorifereve.

Gaz: Subjekti furnizohet me gaz per venine ne pune te kaldajes e cila do te perdoret per ngrohjen e ujit.

Per ngrohjen e ujit per dushe subjekti ka instaluar dhe dy panele diellore per shkrytezimin e energjise diellore me qellim minimizimin e energjise elektrike.

3. VLËRSIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS

Vleresimi i ndikimeve negative analizohet gjate fazes se funksionimit te instalimit Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtaritë e lidhura me to ID 7.7 f. Trajtim ose magazinim i peshqve të ngordhur ose mbetjeve të peshqve.

Vleresimi i impakteve kryhet ne baze te teknologjise qe operon kjo shoqeri. Ne vijim do te studjojme impaktet negative qe implementohen nga ky projekt per parametra te ndryshem mjedisore.

- **Ndikimet negative ne karakteristikat fizike te zones se projektit**

Aktiviteti ku do te instalohet linja e trajtimit ose magazinim i peshqve të ngordhur ose mbetjeve të peshqve do te zhvillohet ne ambientet e ojektit 1-katesh brenda koordinatave kufizuese.

Proceset e punes per kete lloj aktiviteti nuk ndikojne ne toke, kjo per shkak te shtrimit te shesheve si te brendshme dhe te jashtme me shtrese betoni te pa depertueshme nga mbetjet e lengshme. Ky aktivitet nuk ka ndikuar ne zenien e tokes se re ne asnje faze te tij.

- **Ndikimet negative ne habitate dhe biodiversitetin e zones se projektit**

Zona siç eshte pershkruar dhe me larte, nuk dallohet si zone me biodiversitet pasi sipas planit vendor eshte specifikuar si zone per zhvillime UB_Urban, S.Shërbime 40%, B. Bujqësi 30%, IE. Industri dhe Ekonomi 30%ekonomike dhe industriale.

Gjithsesi subjekti do ta zhvilloje aktivitetin e tij brenda objekteve dhe koordinatave kufizuese duke mos prekur asnje siperfaqe të pronave kufizuese.

Shkarkimet ne mjedis dhe prodhimi i mbetjeve

- **Shkarkimet ne ajer**

Gjate zhvillimit te ketij aktiviteti nuk do te kemi gjenerim te pluhurave gjate procesit perpunimit dhe magazinimit te peshkut. Gjate fazes se funksionimit te ketij aktiviteti do te kemi emetime te lehta ne ajer ne mjediset e jashtme. Ky emetim do te vije si pasoj e clirimit te gazeve dhe te grimcave te pluhurit nga levizja e automejteve te transportit te lendeve te para dhe te marrjes se lendes perfundimtare. Gjithashtu emetimet nga djegja e gazit ne kaldaje.

Ne mjediset e brendshme do te kete prezence te paket aromash, kjo si pasoje e procesit te filetimit dhe te perpunimit te peshkut.

- **Shkarkimet ne uji**

Gjate procesit te perpunimit te peshkut, ujrato cilat do te gjenerohen nga larja e produktit te cilat do te grumbullohen nepermjet sistemit te tubacioneve te instaluar ne repartin e perpunimit dhe prej andej do te shkarkohen ne vaskat e dekantimit te ndertuar nga subjekti sipas kushteve teknike. Pasi i neshtrohen procesit te trajtimit fizik, precipitimi i lendeve pezull dhe hollimi i tyre me uje do te shkarkohen ne gropen septike e cila do te pastrohet ne menyre periodike nga kompanit e licesuara per trajtimin e ujrave te ndotura.



Foto 4 Vaska dekantimi

Ujrat nga ambjentet higjeno-sanitare grumbullohen nepermjet tubacioneve te brendshem dhe shkarkohen ne gropen septike te ndertuar sipas kushteve teknike e cila do te pastrohet ne menyre periodike nga kompanit e licesuara per trajtimin e ujrave te ndotura.

Ujrat e shiut pasi grumbullohen nepermjet sistemit te kanalizimeve te kullimit shkarkohen ne kanalin kullues te zones.

- **Prodhimi i mbetjeve**

Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti perpunimit te peshkut jane mbetje shtazore nga pastrimi i peshkut si skeleti, kokat e peshkut, luspa, zorre dhe papasterti te tjera.

Bazuar ne Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 402, date 30.6.2021 "Per miratimin e katalogut te mbetjeve" dhe sipas Aneksit I te ketij vendimi, mbetjet e gjeneruara nga ky aktivitet klasifikohen ne:

02 MBETJE QË DALIN NGA BUJQËSIA (AGRIKULTURA), KOPSHTARIA (HORTIKULTURA), UJËRAT, PYLLTARIA (SILVIKULTURA), GJUETIA DHE PESHKIMI, SI EDHE PËRGATITJA DHE PËRPUNIMET E USHQIMEVE

02 02 02 Mbetje që vijnë nga indet shtazore

02 02 03 Materiale të papërshtatshme për konsum apo për përpunim

02 02 99 Mbetje të tjera të paspecifikuara

Mbetjet do te grumbullohen ne ene te posacme dhe do te meren nga kompanite e licensurara per trajtimin e tyre. Subjekti ka lidhur marveshje bashkepunimi me shoqerine "I.N.C.A." sh.p.k dhe shoqerine "AZ RENDERING" sh.p.k.

Shoqeria "I.N.C.A." sh.p.k me objekt aktiviteti "Perpunim dhe kalibrim te zorreve natyrale per prodhim sallami dhe çdo lloj aktiviteti te lejuar me ligj, perpunim i nenprodukteve shtazore gjysem te perpunuara" eshte i pajisur me licencë nr. LN-0199-02-2020 dt. 27.02.2020.

Shoqeria "AZ RENDERING" sh.p.k me objekt aktiviteti " Grumbullim, perpunim dhe tregtimin e nenprodukteve me origjine shtazore (tokesore dhe ujore). Prodhimin dhe tregtimin e ushqimeve te kafsheve, te thjeshta e te perbera me origjine shtazore dhe bimore si dhe produkte te tjera per kafshe shtepiake, prodhimin dhe tregtimin e dhjamrave dhe vajrave me origjine bimore dhe shtazore te paperpunuara, gjysem te perpunuara dhe te perpunuara per perdorim industrial, prodhimin dhe tregtimin e plehrave organik. Prodhimin, shitjen dhe marketingun e dhjemit te kafsheve per prodhimin e energjise; prodhimin dhe tregtimin e

proteinave dhe derivateve te destinuara per perdorim industrial; i paiisur Licence nr. LN-0199-02-2020 dt. 27/02/2020.

Marreveshja ka si qellim vendosjen e nje bashkepunimi te ndersjellte me aafat 1-vjecar nga data e nenshkrimimit te ketij memorandumi per :

- ✓ Grumbullimin, diferencimin e seleksionimin
- ✓ Ruajtjen e trajtimin ne kushte te papershtatshme dhe
- ✓ Evadimin e transportin.

e te gjitha mbetjeve industriale qe jane, nenproduktet shtazore, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Mbetjet e ngurta qe gjenerohen nga aktiviteti njerezor te cilesuara si mbetje urbane 20 01 01 "Mbetjet urbane" do te hidhen ne kontenieret e mbetjeve urbane te zones.

- **Emetimi i zhurmave**

Zhurmat qe prodhohen vijne kryesisht nga perdorimi i mjeteve te transportit te magazinimit te lendeve te para te peshkut, zhurma e prodhuar nga vete personat qe do te punojne per kete aktivitet, sistemi i aspirimit-kondicionimit. Punëtorët nuk ndodhen në mjedise ku niveli i zhurmave e tejkalon limitin megjithate edhe ne situata te tjera ku niveli eshte me i larte se normat e lejuara ne mjediset e punes, punonjesit mund të perdorin masa mbrojtese per shqisat e degjimit (Kufje ose tapa per veshet).

Ne kete ambjent nuk vleresohen nivele te tilla zhurme dhe si rrjedhoje edhe keto masa nuk do te jene te nevojshme. Nga ky aktiviteti shkaktohen nuk shkaktohen vibrime.

- **Ndikimet sociale te projektit**

Ndikimi i ketij projekti ne mjedisin social, do te jete pozitiv persa i perkete punesimit, por jo vetem.

4. REKOMANDIME PER ZBUTJEN E NDIKIMEVE

Gjate funksionimit te linjes se perpunimit dhe magazinimit te peshkut rekomandohet:

1. Kryerja e aktivitetit brenda koordinatave dhene ne relacion
2. Ne ambjentet e jashtme te aktivitetit te mbillet bimesi dekorative per te permiresuar peisazhin dhe cilesine e ajrit.
3. Të mbahen fikur mjetet e transportit kur nuk është e nevojshme dhe të reduktohen zhurmat në orët e vona.
4. Të reduktohet qarkullimi në orët e pikut të trafikut, për të mos krijuar trafik të rënduar në zonë.
5. Të mos përdoren boritë e mjeteve në qendrat e banuara dhe qarkullimi të kryhet me shpejtësi të ulet.
6. Të behet menaxhimi i mbetjeve teknologjike dhe mbetjeve urbane sipas legjislacionit mjedisor ne fuqi.
7. Investitori të respektojë detyrimet e vendosura në Lejen Mjedisore që do të miratohet nga AKM.
8. Subjekti të respektojë të gjitha masat/normat/planet/shkarkimet e deklaruar në këtë Formular- Kërkese për tu paisur me Leje Mjedisore Tipi B.
9. Subjekti të respektojë dhe zbatojë kushtet teknike në objekt për mbrojtjen nga zjarri dhe të krijojë infrastrukturën e nevojshme për zjarrëfikset.